

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEÇE KAI**

GSK-KPA-A-017/14

**Prishtinë
17 Dhjetor 2014**

Në çështjen juridike të:

L.B.N.

Vranjë

Pala ankuese

kundër

G.D.

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët, Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, Esmë Erterzi, dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/200/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA25012) të datës 18 prill 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 17 Dhjetor 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e L.B.N. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/200/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA25012) të datës 18 prill 2013.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/200/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA25012) i datës 18 prill 2013.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Me datën 01 shkurt 2007 B. L. N. kishte bërë një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (KPA) ku kërkonte ri-posedimin e një lokali afarist - kioske. Ai pretendon se është pronar i kioskës prej 4.00 m² që ndodhet në ngastrën nr. 2025, zona kadastrale në Prizren, rruga “Kralja Petra I Oslobodioca b.b”, Komuna e Prizrenit. Blagoje Nikolić deklaroi të ketë humbur posedimin mbi këtë kioskë për shkak të rrethanave që ndërlidhen me konfliktin e armatosur që kishte ndodhur në Kosovë në vitet 1998/99, duke e përmendur datën 17 qershor 1999 si datën e humbjes.
2. Për të mbështetur kërkesën e tij ai kishte dorëzuar dokumentet vijuese:
 - Vendimin e Kuvendit Komunal të Prizrenit, Departamentit për Ekonomi, Buxhet dhe Financa No.04/1-330-92 të datës 26 mars 1996. Me këtë vendim B. L. N.i jepet miratimi për të hapur një lokal afarist– kioskë si dhe Certifikatën nr. 04/1-330-92 lëshuar nga i njëjti institucion ku ceket se paraqitësi i kërkesës kryen aktivitetin komercial të mbajtjes së cigareve, materialit të zyrës dhe atij shkollor në Prizren në adresën “Kralja Petra I Oslobodioca”.
 - Vendimin e Komunës së Prizrenit, Departamentit për Urbanizëm, Shërbime Komunale, Çështje Banesore dhe Ndërtimtari, nr. 04/4-418 të datës 20 maj 1997. Me këtë vendim, B. L. N.ishte i obliguar që të paguaj tarifën për 12 muaj për shfrytëzimin e tokës ndërtimore në territorin e Komunës së Prizrenit.
 - Kopjen e planit të Zyrës Kadastrale të Komunës së Prizrenit lëshuar me datën 30 korrik 1997. Kjo kopje e planit vërteton se paraqitësi i kërkesës kishte vendosur kioskën në një pjesë të parcelës 2025 të zonës kadastrale të Prizrenit.
 - Vendimin lëshuar nga Komuna e Prizrenit, Departamenti për Urbanizëm, Shërbime Komunale, Çështje Banesore dhe Ndërtimtari, nr. 04/4-351-157, të datës 7 dhjetor 1998 ku lejohet B.L.N. të

bëjë ndërrimin e kioskës ekzistuese me një të re të llojit “Mak Internacional” në një pjesë të parcelës nr. 2025, Komuna Kadastrale e Prizrenit për periudhën 5 vjeçare.

3. Kërkesa ishte regjistruar në AKP me numrin KPA25012.
4. Më 6 maj 2007 zyrtarët e AKP-së konstatuan se në vendi ku do duhej të ishte lokali afarist – kioska ishte një kioske e zënë nga G. D.
5. G. D. merr pjesë në procedurën para AKP-së duke u përgjigjur më 28 shtator 2011. Ajo mohon pretendimet e paraqitësit të kërkesës dhe thotë se kioska e vjetër ishte zhvendosur nga Komuna e Prizrenit dhe me lejen e Komunës ajo kishte vendosur një kioskë të re.
6. Sipas shënimeve kadastrale (UL-71813068) ngastra 2025 është pronë shoqërore e regjistruar në emër të "Shërbimi i Kontabilitetit Shoqëror."
7. Më 18 prill 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) në vendimin e vet grupor KPCC/D/C/200/2013, kishte hedhur poshtë kërkesën. Në arsyetim të vendimit të vet, KKPK ka theksuar se sipas provave paraqitësi i kërkesës kishte të drejtë të shfrytëzimit të përkohshëm ndaj pronës së kërkuar dhe për këtë arsye ai kishte të drejtë të vendos vetëm objekt montazh- kioskë e jo pronë të paluajtshme pra është jashtë juridiksionit të KKPK-së.
8. B. L. N. kishte vdekur më 21 Shkurt 2013, vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar L. B.N., vajzës së paraqitësit të kërkesës. Ajo kishte paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme me datën 11 tetor 2013 (nga tani e tutje: pala ankuese). G.D. kishte pranuar vendimin me datën 12 gusht 2013 në cilësinë e palës përgjegjëse në ankesë dhe ajo nuk ka paraqitur përgjigje ndaj ankesës.

Pretendimet e palës ankuese

9. Pala ankuese pretendon se kërkesa nuk është shqyrtuar në përputhje me ligjin por mbështetet në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ajo kishte shpjeguar se kërkesa ishte hedhur poshtë mbi bazën se prona e luajtshme– kioska është pronë shoqërore.
10. Pala ankuese gjithashtu ka prezantuar:
 - Vendimin të lëshuar nga Komuna e Prizrenit, Departamenti për Urbanizëm, Shërbime Komunale, Çështje Banesore dhe Ndërtimtari nr. 04/5-354-6 të datës 11 shkurt 1997 ku urdhërohet STR “IVA” të zëvendësoj objektet e përkohshme me objekte të reja, megjithatë, faktet e njëjta që përmbajnë dokumentet janë shqyrtuar para AKP-së kështu që dokumentet të dorëzuar së fundi nuk kanë ndonjë ndikim në vendimin final.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

11. Ankesa është paraqitur brenda afatit 30 ditësh siç parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079. Gjykata Supreme ka juridiksion lidhur me ankesën kundër vendimit të KKPK-së. Ankesa është e pranueshme.

Meritat e ankesës

12. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesë ka ta drejtë në një urdhër nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e paluajtshmërisë private, por edhe se ai ose ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në periudhën në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999. Kjo gjithashtu vlen edhe për të drejtat mbi pronën e luajtshme.
13. Pasi që nuk ka dyshim se në vitin 1999 ka ekzistuar një e drejtë e tillë dhe se humbja e mundësisë së shfrytëzimit të kësaj të drejte rezulton nga konflikti i armatosur, pala ankuese duhet të dëshmojë nëse objekti i kërkesës është prona e luajtshme.
14. Në vendimin e KKPK-së theksohet se prona është e karakterit të luajtshëm. Ky vendim me gjasë bazohet në kopjen e vendimeve që ishin paraqitur nga pala ankuese kur e ka parashtrua kërkesën.
15. Se a është prona e luajtshme ose jo, kjo duhet të vërtetohet duke bërë krahasimin e gjendjes faktike me kërkesat për statusin e një sendi si të tillë.

Neni 10 i Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore e përshkruan paluajtshmërinë si në vijim:

1. Paluajtshmëria është një pjesë e caktuar e sipërfaqes tokësore, e cila është e kufizuar ose mund të kufizohet.

Paluajtshmëria përfshinë pasuritë natyrore nëntokësore, bimët me rrënjë nëntokësore dhe objektet tjera të lidhura me bazament tokësor.

2. Një paluajtshmëri përfshinë:

2.1. një ndërtesë, e cila është në pronësi të një personi tjetër për dallim nga pronari i paluajtshmërisë, mbi të cilën është ndërtuar ndërtesa;

2.2. (...);

2.3. (...);

16. Vendimi nr. 04/4-418, i datës 20 maj 1997 thekson se B. L. N. ishte i obliguar që të paguaj një tarifë për 12 muaj për shfrytëzimin e tokës ndërtimore në territorin e Komunës së Prizrenit, si dhe me vendimin nr. 04/1-330-92, të datës 26 mars 1996, B. L. N. i është dhënë pëlqimi për të filluar një afarizëm vet-pronësie – *kioskë*.
17. Kushti e dytë do të ishte që ndërtesa të ishte ” *e lidhur në mënyrë të përhershme me bazament tokësor*”. Fotografitë në dosje të lëndës tregojnë një kioskë të vogël – një objekt të tipit montazhë i cili nuk është i lidhur në mënyrë të përhershme me bazament tokësor dhe duke qenë i një madhësie të këtillë (4 m²) ai mund të largohet me një çmim minimal dhe pa shkaktuar dëm në tokë apo në strukturën ekzistuese.”
18. Sipas dispozitës së nenit 9, paragrafit 1 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore 03/L-154 kioska është send i luajtshëm. Sipas kësaj dispozite ligjore, objektet montazhë të karakterit të përkohshëm, si është në rastin aktual, nuk konsiderohen si sende të paluajtshme.
17. Prandaj, duke marrë parasysh këto konkludime faktike, Gjykata Supreme konsideron se vendimi i atakuar i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës ishte i drejtë dhe i ligjshëm kur vendosi që të hedhë poshtë kërkesën e palës ankuese për shkak të mungesës së juridiksionit për sa i përket kërkesës së palës ankuese për ri-posedim të kioskës. Ndërsa sa i përket kërkesës së palës ankuese për të drejtën pronësore mbi tokën në të cilën ndodhej kioska, KKPK-ja më të drejtë dhe në mënyrë të ligjshme e ka hedhur poshtë kërkesën sepse sipas kopjes së planit dhe provave tjera të dorëzuara, palës ankuese i ishte dhënë vetëm e drejta e përkohshme për shfrytëzim të përkohshëm të pronës shoqërore në një pjesë të ngastrës 2025 të zonës kadastrale të Prizrenit.
18. Prandaj, vendimi i atakua nuk përmban shkelje thelbësore e as zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe asaj procedurale. Ky vendim gjithashtu nuk mbështetet në vërtetimin e gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, siç pretendohet nga pala.
19. Rrjedhimisht, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079 ankesa është refuzuar si e pabazuar dhe është vërtetuar vendimi i KKPK-së për sa i përket lëndës e cila duhej të vendosej me këtë aktgjykim (KPA25012).
20. Ky aktgjykim nuk përjashton dhe kufizon të drejtën e paraqitësi të kërkesës për t'i kërkuar të drejtat e saj në gjykatat e rregullta në Kosovë.

Këshillë juridike

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Willem Brouwer , Kryetar i Kolegjit nga EULEX-i

Esma Erterzi , Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini , Gjyqtar

Urs Nufer , Referent i EULEX-it